**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS**
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

# Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.01.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.12.2020 të parashtruar nga Grupi i Operatorve Ekonomik **"N.N.P. VETONI & NTP Adri Zaun – rrethoja"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare", me Nr. të Prok: 632-20-7526-5-2-1,** nxjerr:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorve Ekonomik **"N.N.P. VETONI & NTP Adri Zaun –rrethoja"**, e dt. 31.12.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare", me Nr. të Prok: 632-20-7526-5-2-1,** kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** , te AK –së, të datës 28.12.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 28.12.2020;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Grupi i Operatorve Ekonomik **"N.N.P. VETONI & NTP Adri Zaun –rrethoja"**, me datë 31.12.2020,ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Renovimi – Rrethimi i terreneve sportive – Kontratë dy vjeçare", me Nr. të Prok: 632-20-7526-5-2-1.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.01.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**1.<u>Për pretendimin tuaj të parë:</u>** ne dosjen e tenderit është kërkuar – specifikuar që kërkohet mjeshtër i saldimit i kualifikuar:
***" ç).– 1 (një) Mjeshtër per saldim i pajisur me diplomë nga shkolla teknike profesionale apo Çertifikatë nga qendra për aftësim profesional të licencuara nga Republika e Kosovës, minimum 3 vite pas diplomimit. Nese Certifikatat janë lëshuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara"***
kurse z.Arton Thaqi është Inxhinjeri i ndërtimtarisë dhe nuk i mbulon kërkesat e Autoritetit Kontraktues të kërkuara në dosjen e tenderit;

**2. <u>Për pretendimin tuaj të dytë:</u>** Nuk janë kërkuar sqarime shtesë me nenin 72 të LPP-së, sepse kamioni i prezantuar nga ju nuk ka pasur tonazhin e kërkuar dhe nuk i mbulon kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Për më shumë shih dëshminë që është ofruar konform listës:


CRA/YPB/VRC 1050890
CRA/YPB/VRC 1050890
07-162-DL
CRA/YPB/VRC 1050890

| | | |
|---|---|---|
| A | | 07-162-DL |
| I | | 01-10-2019 |
| C | | |
| C.2 | | |
| C.2.1 | | [illegible] Thaqi B.I. N.N.P. VETONI |
| C.2.2 | | |
| C.2.3 | | Sopniq Rahovec |
| B | | 18-09-2000 |
| D | | |
| D.1 | | IVECO |
| D.2 | | ML80E |

| | | |
|---|---|---|
| D3 | | |
| E | | [illegible]CFA80A0002318234 |
| 5 | | 2000 |
| S | | |
| S.1 | | 3 |
| S.2 | | |
| Q | | |
| F | | 5800 |
| F1 | | 1320 |
| G | | 4480 |
| X | | |

| | | |
|---|---|---|
| P | | 105 |
| P1 | | 5861 |
| P2 | | Dizel |
| P3 | | |
| R | | E Kuqe |
| 2A | | Kamion Kiper 2 Dyer |

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike https://e-prokurimi.rks-gov.net/**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës